



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KËSHILLI

Nr. 3859 Prot
16

Pogradec, më 04 . 11 .2025

VENDIM

NR. 101, DATË 31 . 10 .2025

PËR

**“MIRATIMIN E HARTËS SË PËRGJITHSHME TË PLAZHEVE TË LEJUARA NË
TERRITORIN E BASHKISË POGRADEC, PËR VITIN 2026”**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, Ligjit nr. 107/2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", i ndryshuar, Ligjit nr. 93/2015 "Për turizmin", i ndryshuar, Ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, "Për pronat e paluajtshme të shtetit", i ndryshuar, V.K.M - së Nr. 321, datë 28.05.2014, "Për sigurinë në det, plazhe, në ujërat e brendshme në thellësi të territorit dhe gjatë ushtrimit të sporteve ujore", i ndryshuar, V.K.M - së Nr. 845, datë 28.10.2020 "Për miratimin e rregullave të hollësishme për zhvillimin e aktiviteteve turistike detare, që kryhen nëpërmjet mjeteve lundruese për qëllime turistike dhe argëtimi", V.K.M - së Nr. 649, datë 16.10.2024 "Për miratimin e rregullores "Për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit", relacionit të grupit të punës të ngritur me Urdhërin e Kryetarit Nr. 546, datë 09.10.2025, si dhe me propozim të Kryetarit të Bashkisë,

VENDOSI:

1. Të miratojë hartën e përgjithshme të plazheve të lejuara në territorin e Bashkisë Pogradec, për vitin 2026, sipas materialit hartografik bashkëlidhur, i cili përmban:

- a) Hapësirat e plazhit për të ushtruar veprimtari si stacion plazhi.
- b) Hapësirat e plazhit publik.



Handwritten signature

- c) Hapësirën ujore të lejuar për notim, zonë e rrethuar me bova.
- ç) Vendqëndrimet e mjeteve lundruese dhe korridoret e lëvizjes së tyre.
- d) Vend-bregëzimet përgjatë hapësirës ujore Fshati Lin- Bar Pelikani, që shërbejnë si stacione sezonale për hyrjen dhe daljen e turistëve/vizitorëve në mjetet lundruese për qëllime turistike dhe argëtimi.

2. Ngarkohet Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit për zbatimin e këtij vendimi.

3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes publike.

KRYETARË E KËSHILLIT

Manjola KAMOLLI



1.Miratuar me 25 vota

2.Vota Pro 25

3.Vota Kundër 0

4.Vota Abstenim 0

5.Zbardhur më date 04.11.2025